# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-444893**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Camp Nou” dhe “Wembley” në garë për të pritur finalen e Champions League, sot pritet vendimi i UEFA-s |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/15/camp-nou-dhe-wembley-ne-gare-per-te-pritur-finalen-e-champions-league-pritet-vendimi-i-uefa-s/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 06:39:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 06:34:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 06:33:00 UTC → 15 shtator 2026, 06:35:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5cd6334a11ce85fca6bb5f60fb1c2ea0053fada1e8d8b3d43cbcd2c2b1b3d149` |
| TEKSTI | `ed9a77dac26ab2455c113d505e529bd6db201af6dea4b34c06cbc5f9f366a67c` |
| PAMJA | `93e035ebb33818bfe4b67ae06a31b5b318e590ccee15d5fa0039ba4ea710e5ed` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `58f108568d642cd71844b8edbd9705df53edf4068a3e1e32a8a1cd04ccf1dd5b` |
| E MËPARSHMJA | `fb19bf8cbb8e710a110cabee8c67425017a7a5d43bde4dea4c776fc724458fb9` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/58f108568d642cd71844b8edbd9705df53edf4068a3e1e32a8a1cd04ccf1dd5b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

CHAMPIONS LEAGUE | FUTBOLL | SPORT | TË FUNDIT

# "Camp Nou" dhe "Wembley" në garë për të pritur finalen e Champions League, sot pritet vendimi i UEFA-s

15/09/2026 08:34



**"Camp Nou" mund të jetë skena e finales së Champions League në vitin 2029, ndërsa UEFA pritet të marrë vendimin këtë të martë në Selanik të Greqisë.**

Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s do të mblidhet gjatë paradites, nga ora 09:00 deri në 13:00, për të përcaktuar stadiumet që do të presin disa prej finaleve kryesore të kompeticioneve europiane.

Për finalen e Champions League 2029 janë paraqitur zyrtarisht dy kandidatura: "Spotify Camp Nou" i Barcelonës dhe "Wembley" i Londrës. Sipas raportimeve, stadiumi katalanas shihet si favorit për të fituar të drejtën e organizimit të ndeshjes më të rëndësishme të futbollit europian.

Kandidatura e Barcelonës mbështetet nga FC Barcelona, Bashkia e Barcelonës, Generalitat de Catalunya, Federata Spanjolle e Futbollit dhe qeveria e Spanjës.

UEFA është në dijeni të ecurisë së punimeve në "Camp Nou". Instalimi i çatisë së re është planifikuar për verën e vitit 2027, ndërsa punimet përfundimtare pritet të mbyllen në fillim të vitit 2028, në skenarin maksimal.

Stadiumi pritet të rikthehet si impianti më i madh në Europë pas përfundimit të plotë të rikonstruksionit, me një kapacitet të planifikuar prej 104.600 spektatorësh, përfshirë rreth 9.400 vende VIP. Ky kapacitet do ta vendoste "Camp Nou" përpara "Wembley"-t, i cili aktualisht ka rreth 90.000 vende.



Sipas vlerësimeve të UEFA-s, Barcelona ka një avantazh të rëndësishëm për shkak të


## SPORT • KRYESORE



Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City



Serie A/ Quajeni 'mjeshtër' të përmbysjeve, Inter mposht Udinesen pas disavantazhit 0-2



Seferi jep mesazhin përpara grumbullimit të Kombëtares, shënon 2 gola në ndeshjen e radhës dhe kalon Rey Manajn



VIDEO/ Jasir Asani gjen golin edhe në Champions League Aziatike, i hap rrugën fitores së skuadrës së Esteghlal



Çfarë po ndodh me Hysajn? Klubet në garë, shqiptari ende nuk ka thënë fjalën e fundit

## ME TË LEXUARAT

Nga një 'like' në Instagram te propaganda serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në Tiranë

Përplasja Kylian Mbappe-PSG, ja si

kapacitetit të stadiumit, por edhe infrastrukturës së qytetit. Kapaciteti i madh hotelier dhe aeroporti ndërkombëtar i Barcelonës konsiderohen pika të forta të kandidaturës katalanase.

Për UEFA-n, organizimi i një finaleje në një stadium me më shumë se 100 mijë vende përbën një tërheqje të veçantë, sidomos për shkak të kërkesës së lartë për bileta për finalen e Champions League.

Fakti që finalja e vitit 2027 do të zhvillohet në "Metropolitano" të Madridit nuk shihet si pengesë që finalja të rikthehet në Spanjë vetëm dy vite më vonë.

Ndërkohë, finalja e vitit 2028 pritet të zhvillohet në "Allianz Arena" të Mynihut, i cili është kandidati i vetëm për atë edicion.

Stadiumi i Barcelonës ka një histori të rëndësishme me finalet e kompeticionit më prestigjioz europian. Në vitin 1989, "Camp Nou" priti finalen ku Milani mposhti Steaua Bukureshtin me rezultatin e thellë 4-0.

Dhjetë vite më vonë, në vitin 1999, stadiumi katalanas ishte skena e një prej finaleve më dramatike në historinë e Champions League. Manchester United përmbysi Bayern Munich me dy gola në minutat shtesë dhe fitoi 2-1.

Një tjetër finale e Champions League në "Camp Nou" do të rikthente një prej eventeve më të mëdha sportive në stadiumin e rinovuar të Barcelonës.

Në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv në Selanik do të përcaktohen gjithashtu stadiumet pritëse për një sërë finalesh europiane.

Superkupa e UEFA-s për vitet 2027 dhe 2028. Faza finale e Champions League në futsall për vitin 2027.

Në Selanik do të merret gjithashtu një vendim për finalen e Champions League për femra në vitin 2028.

Stadiumi "San Mamés" në Bilbao është një prej kandidatëve, pas suksesit të madh të finales së vitit 2024, kur Barcelona mposhti Lyon-in 2-0 përpara 50.827 spektatorëve.

Stadiumi bask, me një kapacitet prej rreth 53.331 vendesh, konkurron me "Groupama Stadium" të Lyonit, "St. Jakob-Park" të Bazelit dhe "RAMS Park" të Stambollit, stadiumi i Galatasaray-t.

Finalja e Champions League për femra në vitin 2027 do të zhvillohet në Stadiumin Kombëtar të Varshavës, në Poloni.

**Top Channel**


përfundoi dueli në gjykatë...

Çfarë po ndodh me Hysajn? Klubet në garë, shqiptari ende nuk ka thënë fjalën e fundit

Nga 2028 gjithçka ndryshon, UEFA kopjon Champions League për kombëtaret

Sabalenka nuk e përballon dot humbjen e US Open, ajo që bëri më pas po bën xhiron e rrjetit

"E vështirë të refuzoja Real Madridin"/ Rodri tregon prapaskenat e kalimit te Barcelona: Ja pse bëra këtë zgjedhje

Deklarata e Mbappé hap një "plagë" te Dembélé, zbulohen detajet

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

Mungonte prej 6 muajsh, Zlatan Ibrahimovic kthehet në Milanello

Serie A/ Quajeni 'mjeshtër' të përmbysjeve, Inter mposht Udinesen pas disavantazhit 0-2


## Champions League »



104 mijë tifozë dhe një arenë e frikshme, pse UEFA po i "dorëzon" Barcelonës finalen e 2029-s

15/09 01:32



Futet në librat e historisë, ndeshja e Champions League që theu çdo rekord të mëparshëm diversiteti

11/09 16:45



Nga shishja në fushë te montazhi në rrjet, kur tifozët bëjnë "snajperin", interneti bën komedinë

11/09 15:45



Rekordi "i paprekshëm" i Ronaldos në rrezik, 5 yjet që mund të bëjnë historinë në Champions

11/09 15:17



Si e ndryshoi një tifoz fatin e stolit në Champions League dhe përgjigjja e klubit

11/09 11:10



Trajneri jep dorëheqjen pas incidentit me tifozët, mbrojtësi e merr lajmin gjatë intervistës live

11/09 10:59

## Futboll »

## Futboll »



Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

15/09 07:30



"E vështirë të refuzoja Real Madridin"/ Rodri tregon prapaskenat e kalimit te Barcelona: Ja pse bëra këtë zgjedhje

15/09 07:21



104 mijë tifozë dhe një arenë e frikshme, pse UEFA po i "dorëzon" Barcelonës finalen e 2029-s

15/09 01:32



Gasperini habit me deklaratën për Balerdi: Më kujton Baresin, askush nuk mund t'i afrohet

15/09 01:27



Çfarë po ndodh me Hysajn? Klubet në garë, shqiptari ende nuk ka thënë fjalën e fundit

14/09 23:48



Inter, Josep Martinez gabon edhe ndaj Udineses. Provedel është gati, çfarë do të bëjë Chivu?

14/09 23:42

## Sport »



Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

15/09 07:30



"E vështirë të refuzoja Real Madridin"/ Rodri tregon prapaskenat e kalimit te Barcelona: Ja pse bëra këtë zgjedhje

15/09 07:21



104 mijë tifozë dhe një arenë e frikshme, pse UEFA po i "dorëzon" Barcelonës finalen e 2029-s

15/09 01:32



Gasperini habit me deklaratën për Balerdi: Më kujton Baresin, askush nuk mund t'i afrohet

15/09 01:27



Çfarë po ndodh me Hysajn? Klubet në garë, shqiptari ende nuk ka thënë fjalën e fundit

14/09 23:48



Inter, Josep Martinez gabon edhe ndaj Udineses. Provedel është gati, çfarë do të bëjë Chivu?

14/09 23:42

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Rusi-Ukrainë, pakt për naftën? Presioni i Trump zbut Zelenskyn



Top News- Fluturimi përfundon në tragjedi, avioni rrëzohet dhe shpërthen në flakë



Top News- "Dronët rus nuk na trembin", NATO i tregon dhëmbët Putinit pas sulmit me dron








Top News- Korrupsioni e skandalet 'zhytin' Ukrainën! Zelensky sërish në hall, buzëqesh Putin

Top Channel/ Fjalime, mesazhe politike dhe kërkesë për dorëheqjen e Ramës, dita e 107 e protestës

Top Channel/ Rekord parash nga emigrantët, 621 milionë euro në gjashtë muaj, por kursi i këmbimit...




**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.